

TË RINJËT



**E SOTMJA DHE E
ARDHMJA E VENDIT
TONË**

UDHËHEQJA E POPULLIT

AGNESA (15), ERBLIN (15), FLORA (14), RINA (14), EDONIS (15), MUHAMET (16)

Në këtë artikull do të lexoni për demokracinë në përgjithësi, dhe rolin e qytetarëve aktiv në një vend demokratik


Çdo njeri ka të drejtën për të qenë i lirë, ka të drejtën e shkollimit, të punësimit, të familjes etj. Njeriu pavarësisht të drejtave të barabarta, ai duhet të ketë tolerancë dhe respekt ndaj tjetrit. Këto janë disa nga elementet e rëndësishme të demokracisë. Ndryshe, demokracia rrjedh nga fjala greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratia“ që do të thotë udhëheqje. Kemi dy lloje të demokracisë: demokracinë përfaqësuese dhe të drejtpërdrejtë. Në demokracinë e drejtpërdrejtë populli vendos në mënyrë direkte, kurse në demokracinë përfaqësuese në mënyrë indirekte. Në demokracinë përfaqësuese bëjnë pjesë edhe dy sisteme të tjera të cilat janë: sistemi parlamentar dhe sistemi presidencial. Vendi ynë, është shtet demokratik me sistem parlamentar ku populli voton deputetët, ndërsa deputetët votojnë Presidentin. Në vendin tonë të drejtën e votimit e kanë të gjithë njerëzit mbi moshën 18 vjeçare sepse në atë moshë janë më të vetëdijshëm dhe më të pjekur.

SI TË JEMI QYTETARË AKTIV

Qytetar aktiv është ai i cili me vet dëshirë kontribuon për vendin e tij si p.sh. pastrimi i lagjes nga mbeturinat, pjesëmarrja në zgjedhjet komunale, ndihma ndaj të varfërve etj.



Grupi Demokratik




Votimi është proces shumë i rëndësishëm për Republikën e Kosovës, sepse me anë të votave populli vendos se kush do të jenë përfaqësuesit e tyre, të cilët do të ketë ndikim në funksionimin e vendit. Edhe pse kemi liri dhe të drejta të barabarta ne duhet të jemi të përgjegjshëm për veprimet tona.



Ilustrim i një vend votimi

KUVENDI DHE DETYRIMET E TIJ NDAJ POPULLIT

ALBIN (15), ARDIAN (15), BLERONA (14), REA (14), SHKODRAN (14), VILDAN (14)



Kuvendi ndal korrupsionin

Të gjithë ne si popull kemi të drejtat tona dhe kemi nevojë për mbrojtjen e këtyre të drejtave, njëkohësisht edhe për shqyrtimin e mendimeve tona.

Kuvendi si organ kyesor për shqyrtimin e këtyre mendimeve na jep ne të drejtën që të shprehim ato mendime dhe ato të merren parasysh nga organet e shtetit. Ashtu siç ne i detyrohemi atyre edhe ata na detyrohen neve. Por si i detyrohemi ne Kuvendit?

Çdo qytetar i detyrohet vendit të vet dhe institucioneve të atij vendi përmes pagesave të taksave dhe zbatimit të ligjeve të cilat Kuvendi i miraton për ne. Ne, detyrohemi që të jemi të saktë dhe të përgjegjshëm në atë aspekt, duke respektuar dhe zbatuar ato ligje.

Por si na detyrohet Kuvendi neve si qytetarë?

Kuvendi ndër funksionet e shumta që ka, ka edhe përfaqësimin e popullit. Kjo na bën të kuptojmë se Kuvendi gjithmonë duhet të jetë pranë brengave të qytetarëve të vet, duke u munduar gjithmonë për të mirën e përbashkët. Kuvendi ka për detyrë që neve si qytetarë të Kosovës të na bëj kushtet më të mira për jetesë. Ai ka për detyrë të kujdeset për nevojat e popullsisë.


Kuvendi përbëhet nga 120 deputetë, ku 100 prej tyre i përkasin kombit shqiptar, ndërsa pjesa tjetër iu përket komuniteteve jo shumicë, si: serbët, romët, ashkalitë, turqit, goranët, egjiptianët.

Kuvendi përpos përfaqësimit të popullit ka edhe disa funksione të tjera si: miratimin e ligjeve, zgjedhjen e Qeverisë, miratimin e buxhetit, zgjedhjen e Presidentit. Kuvendi miraton të gjitha ato projektligje që deputetëve iu duken të përshtatshme dhe të nevojshme për popullin. Këto projektligje mund të propozohen nga vetë deputetët, Qeveria, qytetarët etj.


Kuvendi bën zgjedhjen e Qeverisë dhe Presidentit. Po ashtu Kuvendi e përfaqëson popullin i cili ia ka besuar votën. Si gjuhë zyrtare në Kuvendin e Kosovës, përveç gjuhës shqipe janë: gjuha serbe, ndërsa përkthehet në gjuhën turke dhe në gjuhën angleze për shkak të prezencës së mysafirëve ndërkombëtar dhe deputetëve nga komuniteti turk. Në seancat e Kuvendit kemi të drejtë që të gjithë ne si qytetarë të marrim pjesë, t'i përcjellim ato, dhe për këtë arsye Kuvendi quhet „Shtëpia e Popullit“.



Demokratët e rinjë



Duke e shkruar artikullin për ndarjen e pushtetit



Ilustrim i ndërtesës së Qeverisë



Fryma pozitive gjatë punës




Të koncentruar në punë



Bashkëpunimi në grup



Duke marrë informata për artikull



Vendi ku flasin përfaqësuesit e popullit



Duke i ndihmuar koleges gazetare

NDARJA E PUSHTETIT DHE RËNDËSIA E SAJ

DONART (16), FORTESA (15), ARLIND (15), ERBLINA (14), ARZA (14), RITA (14)

Ndarja e pushtetit është gjë shumë e rëndësishme për një shtet demokratik. Më poshtë mund ta kuptoni se pse ekziston ndarja e pushtetit

Kosova, si shtet demokratik që është, e ka ndarjen e pushtetit. Pushteti ndahet në tri degë: Pushteti Legjislativ, Pushteti Ekzekutiv dhe Pushteti Gjyqësor.

Ndarja e pushtetit bëhet që shteti të ketë demokraci. Po të mos kishte ekzistuar kjo ndarje, atëherë nuk do t'i kishim të drejtat themelore të njeriut dhe as nuk do të kishim barazi, sepse nëse pushteti do të ishte i përqendruar vetëm në njërin prej degëve që përmendëm më lart, atëherë pushteti me shumë gjasë do të keqmenaxhohej. Kuvendi ndryshe quhet edhe Pushteti Legjislativ. Quhet kështu sepse aty bëhen ligjet. Në Kuvend punojnë deputetët, të cilët janë zgjedhur nga populli. Këta deputetë ndryshe quhen edhe përfaqësues të popullit të cilët votohen në zgjedhjet qendrore. Detyrat e Kuvendit janë: të propozoj, të miratoj dhe shfuqizoj ligjet, të zgjedh dhe mbikëqyr Qeverinë si dhe të zgjedh Presidentin.

Dega tjetër është Pushteti Ekzekutiv, e cila është Qeveria. Qeveria mundëson arsimin e nxënësve duke iu ofruar të gjitha nevojat për shkollë. Qeveria zgjedhet dhe kontrollohet nga Kuvendi. Ajo ka për detyrë të na siguroj një jetë sa më të mirë. Këtë detyrë e zbaton duke i siguruar popullit arsimim të mirë, zhvillim ekonomik, sigurim shëndetësor etj.

Pushteti Gjyqësor është dega tjetër, e cila përfshin: Gjykatën Themelore, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme. Në sistemin gjyqësor marrin pjesë gjykatësit, prokurorët dhe avokatët. Prokurori merret me hetimin e rasteve, gjykatësi ndan drejtësinë, kurse avokati mbron të pandehurin.

Ne sot kuptuam se në një shtet demokratik siç është Republika e Kosovës, ndarja e pushtetit është shumë e rëndësishme dhe e domosdoshme.



Duke biseduar



Arlindi i tregon Donartit për Pushtetin Ekzekutiv



Rita duke reflektuar për ndarjen e pushtetit



Gazetarët e këtij artikulli



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „MODEL“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë